




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 168/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković.– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi, - Referues, z.- Blerim Dina Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Mulaj”-Gjakovë , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE- “Euro Asphalt”- Gjakovë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi dhe Sajimi i Ujerave të zeza dhe atmosferike” me nr. prokurimi: 632/18/951/521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) /KK-Gjakovë/ më datën 17.05.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “ Mulaj” - Gjakovë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe Sajimi i Ujerave të zeza dhe atmosferike” me nr. prokurimi: 632/18/951/521 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) "KK - Gjakovë"

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i AK -së /KK-Gjakovë/ lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Ndërtimi dhe Sajimi i Ujerave të zeza dhe atmosferike” me nr. prokurimi: 632/18/951/521 dhe **anulohet në tërësi** ky aktivitet i prokurimit, ndërsa nëse edhe më tutje ka interes AK-ja, atëherë mund ta ritenderojë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Mulaj” - Gjakovë aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës, në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 26.02.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 19.03.2018

Njoftimi për dhënie të kontratës nga Autoritet Kontraktues, lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt: 06.04.2018 ku është rekomanduar për kontratë OE- “Euro Asphalt” - Gjakovë

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “Mulaj”- Gjakovë, me dt: 09.04.2018 ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 12.04.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE “Mulaj”-Gjakovë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Mulaj” - Gjakovë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 23.04.2018 me nr. 168 / 18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi dhe Sajimi i Ujerave të zeza dhe atmosferike” me nr. prokurimi: 632/18/951/521 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) "KK-Gjakovë" duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,7,56,57,59,60,72 si dhe neni Neni 39 dhe 41 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.04.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 30.04.2018, lidhur me pretendimin ankimore te OE ankues “Mulaj” - Gjakovë se ka pasur shkelje te LPP gjegjësisht nenit 1,7,59,56,60,61 dhe neni 70 dhe në finalizim te analizimit dhe shqyrtimit te këtij aktiviteti te prokurimit, konstaton si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se: Nuk keni ofruar dëshmi – licencë nga KPMM-ja, për rërë, zhavorr, bazë betoni dhe bazë asfalti. Ju si OE keni dorëzuar një liste te projekteve dhe disa referenca qe nuk kane përputhshmëri me projektet e prezantuar ne liste. Gjithashtu origjinali i ofertës nuk ka qene identik me kopjet e dorëzuara e cila është ne kundërshtim me piken 33.3 te RRUOPP-se.

Referencat e dorëzuar ne origjinal te cilat kane qene te shkëputura nga dosja nuk gjenden ne kopjen e dorëzuar. Formulari C ne kopje te dorëzuar nuk ka çmim te shënuar.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e pare te eliminimit, sqaron se OE ankues ne ankesën e tij te datës: 23.04.2018, e pranon qe nuk e ka dorëzuar licencën, citat: “Ne nuk e kemi dërguar licencën për beton dhe asfalt pasi qe askund ne pozicionet e tenderit nuk kërkohet asfalt ndërsa betoni kërkohet ne sasi te vogla...”

Eksperti shqyrtues, sqaron se kërkesë e dosjes se tenderit ka qene qe te dorëzohet licenca nga KPMM-ja (për rërë dhe zhavorre, material nga guroret, bazë të betonit dhe bazë e asfaltit.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne kërkesën e dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë vlerëson se OE ankues është i papërgjegjshëm për faktin se edhe vet e pranon se nuk e ka dorëzuar licencën, ndërsa pretendimi se ne pozicionet e tenderit nuk kërkohet asfalt ndërsa beton shume pak, nuk qëndron dhe nuk mund të arsyetohet për faktin se OE gjate fazës se kriterëve është dashur ta sqarohen me Autoritetin kontraktues për ndonjë kërkesë në rast se është e panevojshme. Sa i përket arsyes se dyte te eliminimit dhe pretendimit te OE ankues se e plotësojmë këtë kërkesë te dosjes se tenderit, eksperti shqyrtues, vlerëson se ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se OE ankues e plotëson këtë kërkesë te dosjes se tenderit.

Sa i përket pretendimit te OE ankues se nuk janë kërkuar referenca, por vetëm kontrata, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se tek kriteret teknike dhe profesionale janë kërkuar kontratat dhe referencat.

Ne lidhje me pretendimin se i rekomanduari për kontratë nuk e ka licencën për zhavorr, eksperti shqyrtues sqaron se i rekomanduari për kontrate ka kontrate te nënshkruar me OE “Celi AG” për furnizim me zhavorr. Ne kërkesën e dosjes se tenderit është kërkuar licencë ose kontratë nga një ndërmarrje e licencuar nga KPMM-ja.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, ne lidhje me sigurimin e tenderit te OE te rekomanduar për kontrate, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se sigurimi i tenderit i ka te

gjitha kushtet e parapara ne aneksin 4 te dosjes se tenderit.

Po ashtu ne lidhje me pretendimin e OE ankues, se i rekomanduari për kontrate nuk i ka dorëzuar dëshmi sipas kërkesës 8.1 dhe 8.2 te dosjes se tenderit, eksperti shqyrtues, sqaron se edhe ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se i njëjti i ka dorëzuar dëshmi sipas kërkesës – dëshmi nga banka te vulosur dhe nënshkruar.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues, qe ka te beje me kontratat dhe referencat e OE te rekomanduar për kontrate, eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar te gjitha kontrata dhe referencat i ka ne shtim asfalti ne te cilat mund te ketë edhe kanalizime atmosferike. Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne kontratat dhe referencat vlerëson se kjo kërkesë pjesërisht është plotësuar nga OE i rekomanduar për kontrate.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, se i rekomanduari për kontrate nuk i ka dorëzuar licencat për rrëre dhe materiale gurore, eksperti shqyrtues, sqaron se është i qëndrueshëm ky pretendim per faktin se te licencat e lart përmendura nuk gjenden ne ofertën origjinale.

Ne shkresat e lendes gjenden komunikimet e AK-se, me KPMM-ne, ku AK-ja, ka kërkuar sqarim lidhur me licencat e OE te rekomanduar për kontrate dhe te njëjtit, pra KPMM-ja kane deklaruar se OE “Celi AG” me te cilin OE “Euro asfalt” ka kontrate për furnizim, i ka valide licencën për seperacion – sortues.

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, gjate vlerësimit te ofertave, e ka hapur kopjen nr. 1 te OE ankues me qellim te verifikimit te dy referencave dhe pas hapjes ka vërejtur se OE ankues nuk e ka te njëjtë – plotësuar formularin e tenderin konkretisht çmimin e ofertës nuk e ka vendosur fare ne formularin kopje te ofertës.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar ne tërësi pretendimet ankimore vlerëson se, se ankesa e OE ankues është pjesërisht e qëndrueshme për faktin se disa nga pretendimet ankimore janë te qëndrueshme me lidhje me ofertën e te rekomanduarit për kontrate, ndërsa si operator ekonomik është i papërgjegjshëm për faktin se siç u përmend edhe me lart e pranon se nuk i ka dorëzua dëshmi – licencat e lëshuara nga KPMM-ja.

Po ashtu eksperti shqyrtues, sa i përket zbatimit te procedura te vlerësimit nga ana e AK-se, mendon se AK-ja i ka diskriminuar OE-te, konkretisht ka shkelur nenin 7 te LPP-se, për faktin se AK-ja, OE ankues e eliminon nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se nuk i ka dorëzuar licencat e KPMM-se pa kërkuar sqarime për ketë operator ekonomik, ndera te rasti i OE te rekomanduar për kontratë edhe pse i njëjti nuk i ka dorëzuar ne ofertë origjinale te gjitha licencat e KPMM-se, (për rrëre dhe materiale gurore), AK-ja ka kërkuar sqarime dhe i ka pranuar.

Andaj, pretendimet ankimore te OE ankues për shkelje te dispozitave te nenit 6,7,56,59 dhe 72 janë te qëndrueshme, ndera nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkelje te nenit 57 dhe 60 te LPP-se.

Ne fund ekspertit shqyrtues vlerëson se të dy OE janë të papërgjegjshëm dhe se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet pjesërisht si e bazuar, ndërsa njoftimi për dhënie të kontratës të anulohet dhe njëherit propozon që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në ri-tender, nëse edhe me tutje ka interes AK-ja

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 11.05.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 08.05.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.05.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi i OE ankues, Autoriteti Kontraktues, dhe ekspertit shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Mulaj deklaroj: Falënderoj ekspertin fillimisht që pjesërisht e ka pranuar ankesën tonë, me gjithë atë e falënderoj për mendimin e drejtë që ka dhënë. Ne kemi shpreh pakënaqësi andaj i jemi drejtuar OSHP-së me shkrim ku ju kemi njoftuar për të gjitha. Dyshimet ku i kemi paraparë v dihet, sidomos më brengos rasti kur kanë hapur njërin nga kopjet AK, dhe do doja sqarim çka i ka motivuar të hapet ajo kopje, ku sipas AK-së nuk janë gjetur referencat nga puna që kemi kryer me kompaninë Beni, ndërsa në origjinal të ofertës gjenden referencat e në kopje jo.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Bakalli deklaroj: Nuk jam pajtuar me përgjigjen e ekspertit shqyrtues në disa pika. Për sqarim ekspertit ndoshta nuk ka pas faj pasi nuk ka ditur detajet që gjenden në dosje. Sa i përket hapjes së kopjes komisioni vlerësues ekskluzivisht me ligj në fuqi kryen vlerësimin e ofertave. Në momentin kur e kanë marr ofertën e OE Mulaj i kanë vërejt dy referenca që janë të shkëputura nga dosja.

Në vazhdim me drejtë të tyre kanë kërkuar të hapet njëra nga kopjet sipas ligjit në fuqi. Komisioni ka hap kopjen dhe ka pa se në kopje të OE nuk janë referencat, e kanë kontrolluar kopjen a është e njëjtë me origjinalin siç e thotë ligji, dhe gjatë kontrollimit e kanë parë se edhe formulari C nuk ka çmim në kopje. Pse

nuk jemi pajtuar me ekspertin pse nuk kemi kërkuar sqarime shtesë te OE ankues është se në dosje dhe njoftim për kontratë kemi kërkuar dëshmi të jetë lista referencave të kontratave të realizuara, me shumë, datë, emrin e aktivitetit, emri AK etj. OE në fjalë ka dorëzuar një listë të kontratave ku shihet ndërtimi dhe sajimi i ujërave të zeza, AK-KK Gjakovë dhe shkruan “Shih referencën”. OE në fjalë 2015-2016-2017 nuk ka kontratë me KK Gjakovë. Ligjërisë nuk ka kryer asnjë punë me KK Gjakovë. Në momentin që komisioni e ka parë, ka pyet a ka kontratë OE, dhe në verifikim del se OE Mulaj nuk ka asnjë kontratë në vitet e fundit. I njëjti ka ofruar disa referenca që ia ka lëshuar OE Beni kompanisë Mulaj. Faktikisht OE Beni ka pas kontratë me KK Gjakovë. Të gjitha pagesat, pranimet e punëve, që ka pas menaxher të kontratës dhe anëtar të komisionit që janë të skanuara, janë të lëshuara për OE Beni, ku thuhet qartë se puna komisionit ka qenë e vijueshme çfarë do me thanë se punimet janë përcjell si në aspektin e ekzekutimit të kanalit në fjalë po ashtu edhe në përcjelljen e punimit të dokumentacionit të nevojshëm teknik.

Këto pranime teknike i janë përcjell drejtorit, me CC për zyrën e prokurimit dhe kanë qenë për OE Beni, çka do thotë se dy OE-të e kanë vënë në lajthitje AK-në. Për këtë e arsyetoj ekspertin në fjalë pasi nuk ka qenë në ngjarje për këto dokumente.

Si provë i ofroj panelit kopjet e pranimeve teknike në fjalë. AK nuk ka qenë në dijeni se OE Beni ka pas nënkontrakt. Të gjithë punimet sipas komisionit janë pranuar nga OE Beni.

Çështja tjetër që nuk pajtohem me ekspertin është lidhur me licencën e lëshuar nga KPMM, ku KPMM ka kërkuar nga gjitha AK-të që të gjitha punimet që kryhen nëpër komuna të kërkohej leje licence të lëshuar nga KPMM ose kontratë me një firmë që është e licencuar nga KPMM.

OE i rekomanduar për kontratë Euro Asfalt ka dorëzuar një kontratë të lidhur me OE Celi Ogi për furnizim me material nga Gurorët. Po aty në marrëveshje ka bashkangjitur licencën e Separacionit Sortuesit. AK KK Gjakovë ka komunikime zyrtare me KPMM ku ka kërkuar shkresë nga KPMM për Celi Ogi çfarë licence ka dhe për një OE tjetër. KPMM ka sqaruar se OE Celi Ogi ka licencë për Separacion Sortues dhe licencë për materiale nga Gurorët dhe ka vlefshmëri deri në vitin 2022. Në momentin që KPMM zyrtarisht e ka pranuar se Celi Ogi ka material nga Gurorët dhe në dosje ka qenë të ketë marrëveshje me një OE të licencuar ky kusht është i plotësuar 100%.

Sa i përket OE të rekomanduar për kontratë eksperti thotë se gjitha referencat i ka për shtrim të asfaltit. Për këtë kam kërkuar të jetë dosja në seancën e sotme, dhe mund të them se OE i rekomanduar ka ekskluzivisht kanalizimet për tri projekte të KK Gjakovë, dhe të gjitha rrugët që i ka OE i rekomanduar për kontratë për asfaltim – të gjitha kanë kanalizime atmosferike në Panamasë dhe parallogarit. Edhe pse titulli kontratës është për asfaltim paramasa e kontratave ka kanalizime atmosferike nëpër qytet.

Sa i përket OE të rekomanduar për kontratë i njëjti i plotëson gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, dhe materialet nga gurorët gjenden në dosje të tenderit, sepse pas sqarimeve të bëra konform nenit 72 ato gjenden në dosjen e AK.

Eksperti ka propozuar të anulohet njoftimit për dhënie kontratës pasi nuk ka asnjë OE të përgjegjshëm dhe me këtë nuk pajtohem dhe i rekomandojmë – kërkojmë nga paneli që njoftimi për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi pasi OE i rekomanduar plotëson gjitha kërkesat e AK dhe gjenden në dosje origjinale dhe dosje tonë. Pse nuk kemi kërkuar sqarim përmes neni 72 nga OE ankues, ka qenë se ky OE nuk ka qenë administrativisht i përgjegjshëm dhe ligji nuk lejon sqarime shtesë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z. Basha deklaroj: Sa i përket pretendimeve të OE ankues dhe arsyeve të eliminimit, ku i njëjti pretendon për ofertën e OE fitues se nuk plotëson kontratat dhe referencat, mund të them se dy OE-të si fituesi ashtu edhe ankuesi në përgjithësi e plotësojnë këtë kërkesë. Mirëpo çështje kryesore është se të dy OE-ve si fituesit dhe ankuesit i mungojnë licencat e KPMM dhe në këtë rast AK gjatë vlerësimit ka kërkuar sqarime vetëm nga fituesi i cili është 80.000€ më i shtrenjtë se OE ankues. Duke u nisur nga këto prova kam konstatuar se bëhet fjalë për shkelje të nenit 7 dhe njëherit që të dy OE-të janë të papërgjegjshëm për shkak mungesës së licencave të lartcekura.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE z. Mulaj deklaroj: Sa i përket referencave me kompaninë Beni, ne kemi kontratë me kompaninë Beni. Sa i përket komisionit vlerësues, nga vitet 2015-2016-2017 mua më janë lëshuar mjete prej 550.000€ nga KK Gjakovë.

Ne si kompani kemi kryer 54.000 metra kanalizime nëpërmjet KK Gjakovë. Për mendimin tonë në këtë rast është bërë shumë e padrejtë që nuk na është dhënë mundësia për sqarim shtesë si OE tjetër për një dokument që nuk e kam, përkundrazi AK e kanë përdorur një formë se kinse referencat i kam futur më vonë në zyrë. Do doja të hapet kopja tjetër e ofertës që të shohim se a gjenden referencat që janë në ofertë origjinale. Ne pajtohem me pjesërisht me mendimin e ekspertit pasi është dallimi i madh në çmim të ofertës tonë dhe OE të rekomanduar për kontratë.

Në qasje në dokumente menaxheria e prokurimit më patë thënë se do e vë në rishqyrtim lëndën, dhe pasi është edhe një OE ankesa e tij është aprovuar ndërsa ankesa jonë është refuzuar, dhe AK kanë prituri deri 10 minuta para se të më kaloj afati për ankesë, çka do thotë se kjo ka qenë e qëllimshme që kontrata kurrsesi të mos i jepet kompanisë Mulaj. I ofroj panelit me shkrim fjalën tonë përfundimtare për këtë lënë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Bakalli deklaroj: Sqarime shtesë janë kërkuar për tre OE jo vetëm për OE fitues. Sqarimet janë bërë për tre të OE të përgjegjshëm administrativisht. Sa i përket deklaratimit se nga kompjuteri jonë janë lëshuar 550.000€, janë paguar borxhe të viteve 2012-2013 që kanë punuar për KK Gjakovë, e këto vite nuk kanë qenë kërkesë e dosjes. Dhe ato janë bërë nga kompjuteri i ministrisë që bënë pagesat. Kërkojmë të refuzohet ankesa e OE ankues dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për dhënie kontratës.

Në fund eksperti shqyrtues z. Basha deklaroj: Nuk kam çka të shtoj më shumë, qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve të dhëna në ekspertizë.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit teknik, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor konstaton dhe vlerëson se AK-ja, gjatë vlerësimit të ofertave nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, për faktin se nuk qëndrojnë të gjitha arsyet e eliminimit të OE ankues, konkretisht nuk qëndron arsyeja lidhur me kontratat dhe referencat e OE ankues i cili e ka plotësuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Ndërsa sa i përket dëshmimeve lidhur me licencën për asfalt dhe beton të OE ankues, paneli shqyrtues konstaton dhe vlerëson se përveç që u vërtetua në seancë se i njëjti nuk i ka dorëzuar licencat e lartpërmendura, i njëjti edhe në ankesën e tij e pranon se nuk i ka dorëzuar licencat e përmendura më lart, citat: *“Ne nuk e kemi dërguar licencën për beton dhe asfalt pasi që askund në pozicionet e tenderit nuk kërkohet asfalt ndërsa betoni kërkohet në sasi të vogla”*.

Lidhur me pretendimet e OE ankues, në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë paneli shqyrtues, duke u bazuar edhe në provat e ofruara gjatë seancës dëgjimore nga eksperti shqyrtues, vlerëson se edhe OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka dorëzuar në ofertën e tij licencat për rrëzë dhe materiale gurore, prandaj rezulton se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, në lidhje me sigurimin e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, paneli shqyrtues, sqaron se është i paqëndrueshëm ky pretendim i OE ankues, për faktin se siguri i tenderit i ka të gjitha kushtet e parapara në anëxin 4 të dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës 8.1 dhe 8.2 të dosjes së tenderit, paneli shqyrtues, sqaron se edhe ky pretendim është i paqëndrueshëm, për faktin se i njëjti i ka dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës – dëshmitë nga banka të vulosur dhe nënshkruar.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, që ka të bëjë me kontratat dhe referencat e OE të rekomanduar për kontratë, paneli shqyrtues ashtu siç e ka cekur edhe eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar të gjitha kontratat dhe referencat i ka në shtrim asfalti në të cilat mund të ketë edhe kanalizime atmosferike, mirëpo që nuk është bërë një verifikim i saktë se a ka kryer dhe sa ka kryer punë në ndërtim dhe sanim të ujërave të zeza dhe atmosferik, ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues.

Paneli shqyrtues, vlerëson se AK-ja, gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë OE ankues dhe OE të rekomanduar për kontratë sipas nenit 7 të LPP-së, për faktin se gjatë vlerësimit të ofertave duke u bazuar në çmimin më të ulët të cilën e ka OE ankues është dashur të kërkohej sqarime shtesë edhe nga OE ankues, e jo të kërkohej sqarime vetëm për operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në komisionin vlerësues të AK-së të cilët i kanë deklaruar të papërgjegjshëm të gjithë ofertuesit tjerë, përveç OE të rekomanduar për kontratë, si dhe duke pasur parasysh raportin e ekspertit shqyrtues, faktet që u prezantuan dhe u diskutuan në seancën dëgjimore ku rezultoi se edhe OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, atëherë sipas nenit 44.7 pika (ii) të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP) duhet të anulohet kjo procedurë e prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "KK-Gjakovë"

1x1 OE - Mulaj"-Gjakovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z.Goran MILENKOVIC

